

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 10 MARS 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nëse SPAK-u do ta kishte kryer detyrën me autoritetin që i jep ligji dhe do të kishte përligjur në këtë mënyrë të gjitha pritshmëritë që u parathanë për reformën në drejtësi, nëse do të kishte përbushur edhe besimin e qytetarëve, nuk do të ishim sot në këtë diskutim për të miratuar raportin e komisionit hetimor të Kuvendit për aferën korruptive të inceneratorëve. Madje jo vetëm kaq, por shumë prej personave me funksione të larta shtetërore, që kapardisen përpara komisionit, e që na shfaqen edhe sot këtu nuk do ta kishin pasur fatin të flisnin as para komisionit, as para Kuvendit, por do të ishin në duart e drejtësisë, të izoluar atje ku izoloheh ligjërisht të gjithë ata që kryejnë krime dhe korrupsion me detyrën e shtetit. Mirëpo SPAK-u ua dha mundësinë këtyre zyrtarëve, gjurmët e të cilëve nuk mund të digjen me plehrat e inceneratorëve, por që prej inceneratorëve kanë përfituar miliona euro përmes një skeme kriminale e korruptive, të provuar tashmë.

LSI-ja e ka denoncuar që në mars të vitit 2021 këtë aferë korrupsioni me 3 kallëzime penale në SPAK, me emra, fatura, fakte e shkresa zyrtare, duke demaskuar jo me show, por me fakte në organet e reja të drejtësisë, të cilave u ka kërkuar zbardhjen sa më parë të kësaj afere dhe vendosjen përpara drejtësisë dhe përpara ligjit çdo zyrtar, që ka shpërdoruar detyrën dhe ka vjedhur taksat e qytetarëve shqiptarë. Ajo është një vjedhje që u bë me pretekstin e pastrimit të Shqipërisë dhe shpëtimit të vendit nga emergjenca mjedisore, por që e gjitha rezultoi të ishte thjesht justifikimi i një skeme të një grupi të strukturuar kriminal, që vidhte taksat e qytetarëve më të varfër në rajon, që jetojnë sot me 5,5 dollarë në ditë. Janë 3 skema korruptive të inceneratorëve të Elbasanit, të Fierit dhe të Tiranës, pasi përmes tyre nuk ofrohet asnjë shërbim incenerimi, madje ai i Tiranës nuk ekziston fare. Por, pavarësisht kësaj, pagesat dhe taksat e shqiptarëve për këto tri koncesione kanë shkuar në xhepat e qeverisë, për të realizuar një skemë të evazionit fiskal me vlerë miliona euro.

Deri më tani shteti shqiptar ka paguar 100 milionë dollarë për 3 inceneratorët dhe vetëm Klodian Zoto ka përfituar 53 milionë dollarë në bankë, pasi ka krijuar kompani fiktive për të justifikuar kostot e fryra dhe për të përfituar TVSH-në, duke kryer evazion fiskal në vlerën 25 milionë dollarë. Pra, këta janë një grup njerëzish, Klodian Zoto, Stela Gugallja e Mirel Mërtiri, që zbatonin një skemë korruptive në mbështetje të pushtetarëve. Po sa janë shumtë e parave të shpërdoruara për çdo incenerator? Konkretisht, për inceneratorin e Elbasanit janë shpërdoruar 7 milionë dollarë, për koncensionarin e Fierit janë shpërdoruar 6 milionë dollarë, për koncensionarin e Tiranës, "Integrated Energy BV SPV", shpërdorimi i parave arrin në 2 milionë dollarë, nga koncensionin e inceneratorit të Tiranës ITS janë shpërdoruar 30 milionë dollarë.

Nëse sot qeveria flet për Këshillim Kombëtar, këta nuk kanë denjuar të pyesin këshillat bashkiakë për këto vendimmarrje kaq të rëndësishme, me kosto miliona euro. Armando Subashi nuk ka pyetur këshillin bashkiak për inceneratorin e Fierit, që është vendosur nga Portëz, në Mbrostar, duke shpronësuar një tokë private, për të cilën u shpenzuan 46 milionë lekë shtesë, përveç 28 milionë eurove kosto të inceneratorit, duke shkelur haptazi ligjin e vetëqeverisjes vendore, neni 54, pika 1, që përcakton qartë kompetencat e këshillit bashkiak, i cili e miraton dhënien e zhvillimit të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private nëse ka të paktën 3\5 e votave të këshillit. Në shpërdorim të hapur të detyrës, duke mos dëgjuar protestat e qytetarëve të shqetësuar me të drejtë të njësisë administrative Mbrostar, u vendos ndërtimi i inceneratorit, që duhet të përfundonte në tetor 2018-ës, por afatet janë shtyrë 4 herë. E njëjta situatë është provuar edhe për inceneratorin e Tiranës, në datën 27 mars të vitit 2017 kryetari i Bashkisë së Tiranës, merr angazhim financiar 30- vjeçar për qytetarët e Tiranës, pa e kaluar këtë vendimmarrje në këshillin bashkiak, duke shkelur përsëri ligjin për vetëqeverisjen vendore, edhe pse

Ministria e Mjedisit në mbledhjen që ka zhvilluar më 31 gusht 2017 ka kërkuar me insistim futjen në kontratë të detyrimit për miratimin e saj me vendim të këshillit bashkiak, kërkesë e cila është refuzuar nga përfaqësuesit e bashkisë. Ky është një investim që kap vlerën 128 milionë euro dhe sot janë paguar 40 milionë euro nga taksat e qytetarëve, por inceneratori nuk ekziston, nuk bëhet incenerim, ka vetëm një landfill. Raporti i KLSH-së konstaton një shkelje që shkon në 61 milionë euro. Pra, paguajmë për një shërbim që nuk marrim, për të mos folur për shkresën dhe implikimin e deputetit Bllako në konflikt interesi kur ka qenë sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, i cili ka përfituar nga inceneratorët pagën e babait të tij, i punësuar direkt në inceneratorin e Tiranës, dhe janë jo pak, por 10 milionë lekë në muaj për më shumë se një vit. Po ashtu në shkelje flagëranante të ligjit “Për prokurimin publik” janë inceneratori i Tiranës dhe i Elbasanit. Në kohë pandemie, kur shqiptarët nuk rimbursoheshin për barnat dhe nuk merrnin shërbimin e duhur shëndetësor, vetëm për udhëtime për inceneratorët kanë thithur 1,8 milionë euro.

Pra, kompanitë e konsulencës që këshillonin Klodian Zoto kanë marrë 2,4 milionë euro. Faktet tashmë janë në SPAK që nga marsi i vitit 2021 për Alqi Bllakon, Lefter Kokën, Armando Subashin, Erion Veliajn, Ëngjëll Agaçi, ata janë hallkat kryesore e një zinxhiri të gjatë zyrtarësh, mbi të cilët bie përgjegjësia për këtë megaaferë korruptive. Kjo përgjegjësi fillon nga Kryeministri Rama, i cili duhet të përgjigjet për vjedhjen e 430 milionë eurove, një shërbimi që qytetarëve nuk iu dha kurrë. Sot drejtësia e re është para një provë shumë të fortë. Prej saj pritet të dëshmohet paanësi, integritet, profesionalizëm në zbardhjen e kësaj vjedhjeje kriminale, që u është bërë qytetarëve, duke vepruar me të gjithë forcën e ligjit ndaj cilitdo zyrtari që ka shpërdorur detyrën dhe ka abuzuar me fondet publike. Është koha që kultura e pandëshkueshmërisë të marrë fund dhe askush të mos guxojë më të abuzojë me detyrën apo me taksat e qytetarëve, të cilët, sikur të mos u mjaftojnë e gjithë kjo, sot përballen me varfërinë e thelluar nga rritja e çmimeve të produkteve të shportës, nga rritja e energjisë dhe ajo e naftës, ku tashmë në këtë momente që ne flasim këtu po zhvillohen një protestë e radhës për rritjen e çmimit të naftës. Unë dua të ndaj me ju një fjalë të një vogëlusheje, që foli dje në protestë dhe preku mijëra njerëz dhe shumë prej nesh, ajo tha: unë dua të jetoj në Shqipëri, por nuk dua të jetoj në Shqipëri kur bëhet vend kaq i shëmtuar. Ky është realiteti.